

MËRGIM NË "GALAKTIKËN" NJERËZORE



Pashë me kënaqësi të veçantë ciklin e fundit të pikturave të Gazmend Lekës. Përfytyrimet e tij shfaqen prore mitologjike, me shartesa simbolesh e fantazmagorish, ku sendi, kafsha, njeriu dhe fenomeni bëhen tok. Miti është thelb i artit: miti i trashëguar dhe miti i krijuar së fundmi, miti si zhguall i religjionit dhe miti si trill e fantazmagori artistike. Piktori pëlqen qenie, mjedise e lëvizje sa përtej aq dhe brenda tokës, pasuar e begatuar nga imazhet ëndërrore, amalgamat onirike e përsendëzuese që truri krijon. Ka një frikë brenda tyre. Përmasa është e llahtarshme, ku japin e marrin

e madhërishmja, groteskja, e përçudnuara dhe paradoksalja. Një triptik i kahut të përfytyrimeve eskatologjike si ai me titullin “Si është sipër është dhe poshtë” pranon brenda vetes gjithë përmasat që përmenda pak më sipër. Lart-poshtë është hapësira kozmike, ajo lëndorja, por ca më shumë lart-poshtë është hapësira e pafund e shpirtit, ajo e mirëfillta, platonikja, ku sendi shndërrohet në hije dhe hija bëhet send. Ndonëse njeriu nuk është i pranishëm fizikisht në bulën hapësinore të triptikut, ai paramendohet. Është aty, i fshehur, si hija e hijes. Ose ndërfitet pjesërisht, si diçka ende e paplotësuar, e nënkuptuar. Është figura mitologjike e një qenie parake ku amalohen format e një përbindëshi uJOR, ndoshta një oktapod me këmbët e pleksura, një lloj kërmilli a diçka e ndërthurur me gjymtyrë njeriu, madje edhe me një maskë kësisoj, krejt paradoksale e sfiduese në atë masë të stërmadhe mishi. Kafsha dhe njeriu, në një trajtë amorfë, të pagdhundur ende, të rëndë, paksa të squllur. Mjedisi është kozmik, mes një shtjellë yjesh e dritësimesh e një galaktike diku. Ajo që më befason dhe vetiu të çon te mendimi e përfytyrimi religjioz është një send katror i zi, që bie vrik nga sipër poshtë, përballë kësaj qenieje. Ngjan si një libër i madh, ndoshta Bibla, Fjala, Zoti në formën e pastër të shenjave e simboleve shkrimore ngujuar përbrenda. Por ngjan edhe si Guri i Shenjtë i Zi i Mekës, ku miliona besimtarë shkojnë për vit në ritualin katarsik të Haxhit. Një botë që po tronditet nga drita, energjia, shtjella e lëvizjes, ku forma përbindshore duhet t’ia lë vendin një tjetër forme, më të zhdërvjelltë, më humane, më pranë Zotit dhe Shkronjës, më pranë dritës. Një transformim kozmik po ndodh. Ndoshta një transformim i vetë qenies. Harmonia po vjen. Përçudja ikën. Një tjetër dritë po shfaqet. Demiurgu ka zbritur në tokë një mesazh të ri: ajo që është humane.

Krah pikturës që vendoset në mes të triptikut janë dhe dy të tjera po të një mënyre konceptimi, me të tjera figura mitologjike, me të tjera imazhe. Majtas syri rreket të krijojë pamjen e një qenieje të stërmadhe, ndoshta një breshke a zvarraniku prehistorik që popullonte tokën tonë dikur, para se njeriu të shfaqej e të bëhej zot i saj. Djathtas është forma e një shpendi, edhe ky i stërmadh, ndoshta një dragua flakëlëshues që zotëronte qiejt. Qenia e parë e lidhur me tokën, e rëndë, e mbledhur, e squllur, qenia e dytë e lidhur më së shumti me qiellin, flatruese, energjike, pllenues yjesh. Dhe gjithkund kozmosi

si prani, si trysni, si peizazh, si metaforë e bërjes dhe zhbërjes, e pranimit dhe refuzimit, e veprimit dhe bashkëveprimit. Kozmosi si energji, si dritë, por edhe si palëvizshmëri, si terr. Kozmosi si shenjë e simbol: sfera dhe piramida, dy format bazike ku migron mendja dhe aftësia e saj për të realizuar sinteza gjeometrike pitagoriane pranë konceptit antik të Zotit apo Gjithësisë. Miti, kjo materie sa efemere aq kompakte dhe agresive, gjendet edhe në tablonë “Kopshti i Edenit”, por tashmë thjesht në rolin e pretekstit. Disa mollë, simboli i dijes së Zotit dhe i mëkatit (kur fryti i artë kafshohet nga Eva dhe Adami), kanë rënë mbi një trup që s’ të shpie kund, te diçka konkrete, për shembull. Jemi sërish në përfytyrime kozmike. Por nëse mollët janë konkrete si simbolet e rrokshme të rrëfenjës biblike dhe trupi i stërmadh nuk identifikohet, përkundrazi një llambë që ndriçon sipër mos vallë është drita e Zotit, drita që na jep kënaqësinë e kuptimit? Apo është thjesht drita e një studioje piktori, ndezur netëve të gjata të kërkimit e pagjumësisë, të makthit dhe halucinimit estetik? Jam tronditur nga gjetja e jashtëzakonshme e tablosë “Engjëlli i zi më pëshpërit”, ku figura e piktorit Leka, ashtu e kërrusur, ashtu e përvuajtur, ashtu e vërtetë e reale pranëvitet me figurën e një qenieje trillane, e afërt me femrën, por me një fytyrë si maskë, e ndriçuar fort, që ia ka ngulur syrin. Edhe si një xixëllonjë duket, edhe si një robot eksplorues planetësh, edhe si fuqia e njohur që e kërkohet dhe fuqia e panjohur që e dëbojmë dhe i trembemi. Por s’ka rëndësi fare kjo që po them. Shëmbëllimet dhe qasjet janë vetjake, sipas vizitorit dhe impulsit të perceptimit në çastin e shikimit. E rëndësishme është bukuria formale piktorike që të grish, të zgjon mendime, të rrëmben në realitete virtuale e të degdis diku që as ti vetë se di se ku pikërisht. Vegimi ëndërror edhe këtu është trallisës. Njeriu kërruset, ndjehet i pafuqishëm, i mahnitur, rob i asaj që s’ e kap dot. Platitet. Përpëlitet. Po ç’janë këto qenie që flatrojnë mes territ dhe dritës, pikëlimeve të bardha që krijojnë relieve shprese dhe energjie dhe njollave të mëdha të zeza që të gëlltisnin e të bëjnë sakaq një hiç? Një hapësirë e rrafshët blu diku, një relief malor dhe befasisht, pas këtij vizioni onirik ja ku gjithçka bëhet e përkorë: figura e piktorit Gazmend Leka, diku e mbështetur në murin (mbase) të studios së tij, me fytyrën si në dilemën filozofike hamletiane: Ç’ të bëj? Dhe plot elegancë, në kuvendim me të, përballë, figura mitologjike e një qenieje

femërore. Kush është ajo? Mos vallë frymëzimi krijues në përpëlitjen e kërkimit, në boshin mundonjës të gjetjes së idesë, formës, të artit vetë? Mos vallë drita e fortë që befas na vjen dhe na mbush mendjen, duke na bashkuar me të panjohurën e madhe, me atë që s'po e rroknim dot, me Zotin si zbulim e si dije? Mos vallë është erosi ynë, brenda vetes sonë, si energjia dhe flaka e krijimit, pa të cilën s'bëjmë dot art? Dhe sërish them: E ç'rëndësi ka? Mjaft që mendja ime provokohet. Mjaft që forma e bukur e sugjestive e imazhit të përfutur më zgjon asociacione dhe unë dua të fluturoj mes krahëve të tyre piktorike. Nga miti biblik i prerjes së kokës së Gjon Pagëzorit nga mbreti Herod dhe kërcimi sa erotik, ekstazik e makabër që bëri e mbesa, Salomeja, me kokën e shenjtit mbi tepsi, piktori krijon jo aq një gjendje ankthi, tmerr dhe marrëzie, por diçka më të qetë, si të thuash të "përrjashtuar", një postmortum, ku nga pas një tufë yjesh sikur i bëjnë "iso" këngës-valle të kriminit të porsakryer. Madje, sepse mendja ime shkon te arketipi piktorik i natyrës së qetë, ku ironia është kaq e pamëshirshme dhe e pafshehur, saqë kthehet në cinizëm ndaj teprisë së egos njerëzore, ndaj aktit të kriminit si të tillë. Krimi estetizohet. Krimi kundrohet si vepër arti. Salomeja e zhveshur, si një balerinë diku në kabinën e saj pas apo para shfaqjes, e shikon dhe e ndjen veprën e saj kriminale pikërisht si të ishte përballë një objekti estetik. Ka një aromë prej teatri e gjitha kjo. Vetë koka e Gjon Pagëzorit mbi tepsi, e mbuluar pjesërisht nga një vesk ngjyror gjaku të mpiksuar a një maskë, ngjan si një kokë e skulpturuar, si statujë e vepër arti. Edhe Salomeja është estetizuar. Ajo ka vendosur para syve një maskë të zezë. Mund ta konotojmë shenjen si simbol i dekoduar lehtësisht: maska e vrasjes, tejqyra e së keqes. Por nuk më duket kaq e thjeshtë. Mendja sërish më shkon te teatri, te loja, te vallëzimi, te "ballua me maska". Përmes lojës, teatrit, baletit, artit fshihet e mu aty kryhet krimi. Krimi vetë është një lloj teatri. Njeriu bën krim duke e estetizuar atë. Pikërisht edhe Salomeja e këqyr "veprën" e tmerruar të marrëzisë së saj, kokën e prerë të Gjonit, jo drejtpërdrejt por përmes maskës. Në flokë i është vendosur madje një trëndafil i kuq i madh. Është trëndafili i erosit të munguar e të dëshiruar (në gjallje jo, në vdekje po), e kuqja e gjakut dhe e epshit, e kriminit dhe e tërbimit. Po faji ku është? Estetizimi i kokës së Pagëzorit, ashtu e qetë dhe e shndërruar në formë skulpturore, nuk shpreh tmerr, as vuajtjen

e ekzekutimit, përkundrazi është e qetë, e paqme, pa shprehje, madje inerciale. Kurse fytyra e Salomesë sikur shpërndan tek ne veçse dritë, bukuri, ngjyra, lumturi, ekstazë erotike. Të vrasësh do të thotë të këndellesh, të lumturohesh! Oh, çfarë tmerri?! Oh, çfarë përbindëshi i fshehur në kurmin e një gruaje?! Oh çfarë kënaqësie kriminale e njeriut që vret dhe vrasjen e kthen në argëtim, në vallëzim, në profani libidiumi. Dhe krimi bëhet relikte, bëhet skulpturë, bëhet vepër arti! A ka më nevojë të komentosh mbi gjithë këtë kundërshti tmerruese, mbi natyrën e zhbërë të njeriut të zvetënuar, mbi këtë bjerrje jo thjesht morale e dokesore, ku mes martiriumesh e flijimesh sublime do të artikuloleshin më pas ligjet e reja të humanizmit, Ligji i Ri i Perëndisë i jetësuar nga vetë Jezui dhe doktrina e tij fill pas vrasjes së Pagëzorit. Jo aq nga mendimi dhe dimensionimi mitik se sa nga forma piktorike, jam shtangur e kam qëndruar gjatë në tablonë krejt të veçantë e shumë vizuale: “Krim-Krijim”... Koka e skulpturuar e piktorit Gazmend Leka është vendosur mbi një tavolinë pune. Ajo është e rrethuar tej e tej me një mori thikash, pastaj darë, pinca, dalta. Në planin e parë janë vendosur kuba, vizore, figura gjeometrike dhe një këmbë manekini. Drita rreh fort dhe e akumuluar tek portreti i piktorit, qendra e kompozimit. Ai ka një pamje heshtane, të menduar, thuajse solemne, thuajse pa shprehje a të paqme, si duke shikuar a ajgëtuuar diçka që është jashtë e brenda tij. Gjithë ajo rekuizitë thikash e veglash mos ndoshta janë vuajtjet dhe martiriumet e krijimit, nganjëherë tmerri i boshit tonë kur shpirtin e kërkimit duam ta mbushim me materien e re që e kërkujmë dhe e kërkujmë me ngulm? Përballë, të tjera objekte, që matin, që distancojnë, që të shtyjnë në mendime, që llogaritin. Mos ndoshta është arsyeja e artistit, kthjelltësia e mendimit dhe domosdoja e drejtpeshimit, kur “tmerri” i procesit krijues, pasi ka “therur” lëndën e përfytyruar, pra “bishën” që ulërin shpirtit të piktorit në çastet e ekstazës dhe deliriumit, rreket të qetësohet, të rishikohet, të fitojë arsyen dhe balancën e saj, duke e futur pikërisht atë “bishë” në kafazin e ligjësive estetike? Unë kam qejf ta dekodoj kështu mendimin e Lekës. Një tjetër ka gjithë të drejtën ta dekodoj ndryshe. Se ja që arti i tillë është, na fton në një rrugëtim mes misterit dhe shumësisë së qasjeve. Në fund të fundit perceptimi është ai që e bën artin ta tejkalojë kohën e një filli, kohën konkrete, duke sfiduar njëkuptimësinë, cakun e ngushtë të impaktit

që buron e jetësohet veçse brenda një hapësire. E mrekullueshme më është dukur si gjetje tabloja “Bukë, kripë, zemër për lajmësin”. E ngopur përplot ide. Sa reale, edhe mitologjike. Sa e ftohtë e racionale aq e ngrohtë dhe emocionale. Lart është figura e një nëne, do të thosha e kohëve të fundit, sepse ka... edhe syze?! Është nëna e atij që vret dhe e atij që vritet: nëna e pikëlluar shqiptare që vuan vrasjen e birit, por dhe nëna që përlij e nxit birin për gjakmarrje. Poshtë është historia. Thelbi. Metafora. Një tors me kokën e prerë, mbi supet e tij ngrihen lart dy gjymtyrë, njëra si pulpë këmbë e tjetra si krah. Të dyja së toku na çojnë gjithë po te brirët e djallit, pra te nxitja e frymëzimi djallëzor që mëkon brezave e shekujve turbullirën mendore të shqiptarëve. Djalli që na ngatërron, prandaj ende s’po dalin nga labirinti përbindshor i Minotaurit vrasës e gjakatar. Dhe aty, mbi tavolinë, ndriçuar fort, shohim një risk buke mbi një copë letër, përbri saj një thikë. Bukë dhe thikë. Ushqim dhe krim. Jetë dhe vdekje. Është kjo dikotomi mortore që kosit mishin e butë të jetës. Një keqkuptim i madh. Një përlijje e krimit në papërlijjen e të drejtës për të jetuar. Po ç’është kështu me ne shqiptarët vallë? Ç’është kjo “gjakftohtësi” për të shtruar në sofër vdekjen (thikën), sikur t’i thoshe mikut: Bujrum, të pres me bukë kripë e zemër, se je në besë, dhe po aty të vras, sepse jam pjesë e një antropologjie gjaku, hukamë hakmarrjeje që s’njeh paqe, mëshirë dhe falje. Ah, ky qerthull i mbyllur, tmerrues e pa rrugëdalje! Një sy tjetër mund të shtojë diçka tjetër, ndoshta fare kundër meje. Ani, i tillë është arti, të tilla janë kodet e tij, e tillë është mistika që ai ngërthen përbrenda e riprodhohet në mijëra forma nga përjashta. Arti i Gazmend Lekës është pikërisht i tillë. Arti që bukurinë estetike, mitin, fantazmagorinë e pjelloron me idetë dhe filozofinë, me dijen dhe mençurinë. Prandaj mua, dhe shumë si unë afërmendsh, e duam fort këtë piktor. Ai hyn atje ku edhe ne vetë nuk dimë se si t’u vëmë emër turbullirave tona, anktheve tona, ontologjisë sonë, misterit tonë, të pathënave tona...Faleminderit Leka që mendjen ma cyt e mërgon oqeanit të galaktikave njerëzore, misterit të qenies, duke u rrekur të mësoj aty notin e meditimit, notin e sqimës, hijeshisë dhe bukurisë së artit...